



**TV DUKAGJINI**  
**Ermal PANDURI**  
**Drejtor**  
**Pejë**

**Ankesa Nr. 2017/213 KPM vs TV DUKAGJINI**  
**Ref:1711/1277/KPM/am**

### VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2017/213 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV DUKAGJINI (“Pala Përgjegjëse”)**

---

#### Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë Udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
3. Pala Përgjegjëse edhe në Zgjedhjet e Përgjithshme 2017 në Republikën e Kosovës, si rezultat i transmetimit të spoteve politike me prezencë të fëmijëve dhe duke transmetuar konferencën për gazetarë të subjektit politik PDK, është sanksionuar me Vërejtje, me Vendimin Ref: 1708/780/KPM/am, të datës 10 gusht 2017, për shkelje të nenit 9 paragrafit 7 të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
4. KPM me datën 21 shtator 2017 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore.

5. KPM ka bërë monitorimin e programit të Palës Përgjegjëse që nga fillimi i fushatës zgjedhore për të verifikuar pajtueshmërinë me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet. Bazuar në raportin e monitorimit të datës 23 tetor 2017, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë heshtjes zgjedhore ka transmetuar emisionin "Best of Personale" ku personazhet politike flasin për jetën e tyre, si: Dardan Mulliqaj, Blerta Deliu, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi, Muharrem Mavraj. Në ditën e zgjedhjeve, më 22 tetor 2017, Pala Përgjegjëse ka transmetuar një historik të partive politike LDK e PDK. Po ashtu, gjatë ditës së zgjedhjeve ka transmetuar konferencat për gazetarë të PDK, AAK dhe AKR nga selitë e tyre, ku janë parë logot e këtyre partive dhe emri i kandidatit të PDK për Prishtinën.
6. KPM, në bazë të të gjeturave nga raporti i monitorimit, me datën 23 tetor 2017, i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse, duke e njoftuar për shkeljet e bëra dhe duke e udhëzuar Palën Përgjegjëse të veprojë në pajtim me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në të kundërtën Zyra Ekzekutive e KPM-së do t'i rekomandojë Komisionit të KPM-së të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.

### Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton Pala Përgjegjëse në ditën e zgjedhjeve, më 22 tetor 2017, ka transmetuar një historik të partive politike LDK e PDK. Po ashtu, gjatë ditës së zgjedhjeve ka transmetuar konferencat për gazetarë të PDK, AAK dhe AKR nga selitë e tyre, ku janë parë logot e këtyre partive dhe emri i kandidatit të PDK për Prishtinën, duke vepruar në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet, i cili përcakton se:

*"Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve."*

Pala Përgjegjëse në bazë të këtij neni e ka për obligim që të mos publikojë çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.

8. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

### Vendimi

9. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
10. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, sanksionon me gjobë në shumën prej 2,000 (dymijë) euro Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

